



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
NJËSIA PËR KORDINIMIN E MARRËDHËNIEVE ME BE

Nr. 897 Prot

Pukë, më 27.04.2023

PROJEKT - VENDIM

Nr. 1, Datë. 27.04.2023

PËR

Miratimin e Projektit ‘AKSIONI I PËRBASHKËT PËR MBROJTJEN E MJEDISIT – JEP A’, me Nr. Reference të aplikimit: **EuropeAid/171769/ID/ACT/MULTI**, të realizuar ndërmjet Bashkisë Pukë dhe Komunës Guci, me thirrjen e 3-të të skemës së granteve, programi ndërkufitar Mali i Zi-Shqipëri 2014-2020 nën instrumentin për Asistencën e Para-Aderimit (IPA II)

Baza Ligjore:

Ligji Nr.139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Vendimin e Këshillit të Bashkisë me Nr.68 datë.30.12.2022 “Për Miratimin e Programit Buxhetor Afat –Mesëm 2023-2025 dhe të Buxhetit të vitit 2023 dhe Marrëveshjes së Partneritetit Nr.750 Prot, datë.04.04.2023 ndërmjet Bashkisë Pukë dhe Komunës Guci, Mali i Zi.

VENDOSI:

1. Miratimin e Projektit ‘ Aksioni i përbashkët për mbrojtjen e mjedisit – JEP A’, me vlerë totale **300,420** (treqind mije e katerqind e njezet) Euro, prej të cilave **112,521** (njeqind e dymbëdhjetë mije e pesëqind e njezet e një) Euro janë fondi i akorduar nga projekti për Bashkinë Pukë, të përcaktuara me zëra specifik në kolonen 15 të buxhetit të projektit.

Kalimi i fondeve nga Koordinatori (Komuna Guci) kundrejt Bashkisë Pukë do të realizohet me 3(tre) transhe në zbatim të marrëveshjes së partneritetit ndërmjet Bashkisë Pukë dhe Komunës Guci:

- Transhi i parë me vlerë **88.209,91 Euro**
- Transhi i dyte me vlerë **13.059,88 Euro** ,
- Transhi i tretë (balanca) **11.252 Euro**.

2. Miratimin e bashkëfinancimit në vlerën **15 566.45 Euro**, të cilat do mbulohen nga kontributet në natyrë dhe Burimet Njerëzore të Bashkisë Pukë.
3. Për zbatimin e këtij projekt-vendimi ngarkohen :Drejtoria e Administrimit të Përgjithshëm , Sektori i Prokurimeve Publike dhe ai Juridik , Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe e Administrimit të Territorit , Njesia e Kordinimit të Marrëdhënieve me BE.

Hartuesi

Elis Mehmeti




Juriste

Aida Sinani



KRYETARI

Gjon Gjonaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
NJËSIA PËR KORDINIMIN E MARRËDHËNIEVE ME BE

Nr. 277/Prot

Pukë, më 27 / 04 /2022

Relacion

Për Këshillin e Bashkisë Pukë .

Të nderuar Këshilltarë !

Bazuar në ligjin 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore “; Vendimin e Këshillit të Bashkisë me Nr.68 datë.30.12.2022 “Për miratimin e Programit Buxhetor Afat-mesëm 2023-2025 dhe të Buxhetit të vitit 2023 “:

Po ju informojmë me anë të këtij relacioni se Bashkia Pukë në bashkëpunim me Komunen Guci me **Nr.Reference të aplikimit : EuropeAid/171769/ID/ACT/MULTI** ; është shpallur fituese me project-propozimin “**Veprim I përbashkët për mbrojtjen e mjedisit JEPA**” në kuadër të thirrjes 3-të të skemës së granteve “Programi ndërkufitar Shqipëri –Mali I Zi 2014-2020 nën Asistencën e Para-Aderimit (IPA II) “ .

Ky project financohet nga Bashkimi Evropian në Bashkëfinancim me Bashkinë Pukë dhe Komunen Guci , e cila është partneri lider në këtë projekt.

Projekti do të zbatohet për një periudhë **2-vjecare** .

Projekti “**Veprim I përbashkët për mbrojtjen e mjedisit JEPA**” synon përmirësimin e cilësisë së shërbimevë të lidhura me mjedisin dhe paisjeve të nevojshme nëpërmjet paisjes me automjet per grumbullimin e mbeturinave , materialet e nevojshme të punës .

Qëllimi I përgjithshëm I projektit është përmirësimi I cilësisë së shërbimeve të lidhura me mjedisin nëpërmjet paisjes me makinerite dhe materialet e nevojshme .

Grupet e përfituese :

Banorët e qytetit Pukë

Njësitë administrative

Angazhimi I ofruar nga Komisioni I Bashkimit Evropian është :

Buxheti total I projektit : 300,420 Euro

Bashkia Pukë përfiton : 112,521 Euro

Angazhimet e Bashkisë Pukë :

- Të implementojë në bashkëpunim me partnerët e projektit aktivitetet e parashikuara .
- Të mirëmbaje automjetin dhe paisjet që do të blihen në kuadër të projektit .
- Të përdorë automjetin dhe paisjet në shërbim të Bashkisë Pukë për mjedisin .
- Të bashkëfinancojë 15% të shumës totale të projektit (15,566.45 Euro) të cilat do të mbulohen nga kontributet në natyrë dhe nga Burimet Njerzore të Bashkisë Pukë .

Plani I aktiviteteve për periudhen 2 –vjecare të zbatimit të projektit **“Veprim I përbashkët për mbrojtjen e mjedisit JEPA”**, do të zbatohet nga Bashkia Pukë , ku janë përgjegjës Drejtoria e Administrimit të Përgjithshëm , Sektori I Prokurimeve Publike dhe ai Juridik , Drejtoria e zhvillimit Ekonomik dhe e Administrimit të Territorit , Njësia e Koordinimit të Marrëdhënieve me BE .

Hartuesi

Elis Mehmeti

